



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

---

I.AGJ.nr.1/2024-3

Janar 2024

Plani Strategjik për vitin 2024  
PËR: Këshillin Gjyqësor të Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN  
**KRYETARJA**  
**SHPRESA EMRA**

JANAR 2024

## PËRMBAJTJA

- I. Hyrje – Përmbledhje ekzekutive*
- II. Organizimi dhe Raportimi*
- III. Monitorimi*
- IV. Përfundimi*



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENË - BASIC COURT OF PRIZREN

## **I. Hyrje – Përmbledhje ekzekutive**

Plani strategjik për efikasitetin dhe prioritizimin e lëndëve brenda sistemit të gjykatës 2022-2025, është prioritet dhe udhëzimi kryesor për punën profesionale të Gjykatës Themelore në Prizren gjatë vitit 2024. Ky plan, përmban në mënyrë të qartë dhe precize hapat për efikasitetin profesional dhe për secilin akter ka të sqaruar në mënyrë të qartë dhe të saktë detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga ky plan.

Përveç aktivitete dhe planifikimeve të paraqitura në këtë plan, Gjykata Themelore në Prizren dhe degët Suharekë & Dragash, do të kryejnë veprime dhe aktivitete tjera të nevojshme në baza ditore dhe mujore, me qëllim efikasiteti dhe ofrimit të shërbimeve kualitative për qytetarët dhe palët.

Andaj referuar kësaj, pas riorganizimit në vitin 2022 dhe 2023, Gjykata Themelore në Prizren, gjatë vitit 2024 synim kryesor ka zgjidhjen e lëndëve në afat sa më të shkurtër kohor, sidomos në Divizionin Civil dhe trajtimin me shumë kujdes të rasteve me interes publik në Departamentin për Krime të Rënda, në përputhje me parimet e drejtësisë.

Për të realizuar këtë planifikojmë mbikëqyrjen e përditshme gjyqësore dhe menaxheriale për zbatimin e këtij plani, përpilimin e raporteve të rregullta mujore dhe tre mujore, për trajtimin e rasteve specifike të ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut, me qëllim të rritjes së besueshmërisë në gjykatë.

Që nga aprovimi i Planit Strategjik 2023 si Kryetare e gjykatës, kam zhvilluar takime të veçanta, me udhëheqësit e divizioneve, me gjyqtarë të secilit departament dhe të gjithë gjyqtarëve i 'u është dorëzuar Planit Strategjik, duke u udhëzuar në mënyrë specifike për obligimet dhe detyrat që rrjedhin nga ky plan strategjik për secilin gjyqtarë dhe për gjykatën si institucion.

Në kuadër të këtij plani theks të veçante për këtë vit do të jetë zgjidhja efikase e lëndëve të korrupsionit, qëndrueshmëria e Sistemit Qendror të Evidencës Penale, adresimi dhe zbatimi i rekomandimeve të dalura nga vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare që monitorojnë sistemin gjyqësor, zbatimi i planit për veprim lidhur me ekzekutimin e lëndëve dhe unifikimi i procedurës së ekzekutimeve në të gjitha gjykata, respektimi i afateve të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, rritja e numrit të seancave produktive. Kurse sa i përket administratës do të përpilohet dhe do të zbatohet programi për trajnim të administratës, do të bëhet përmirësimi i menaxhimit të dosjes së lëndës gjyqësore në mënyrë fizike, respektimi i afateve të lëvizjeve të lëndëve dhe fuqizimi i menaxhmentit të gjykatës për të siguruar mbikëqyrje mbi zbatimin e punës dhe efikasitetin e gjykatës .

Gjatë vitit 2023 ka filluar implementimi i projektit të video dhe audio incizimeve i cili gjatë muajit janar 2024 do të përfundojë në tërësi dhe do të fillohet me realizimin dhe zbatimin e të njëjtit. Andaj, në fillim të vitit 2024 do të kryhen trajnimet për gjyqtar dhe stafin përcjellës për

shfrytëzimin e sistemit audio dhe video incizime gjatë gjykimit dhe do të sigurohet që këto incizime të gjykimeve të jenë në harmoni me Rregulloren e miratuar nga KGJK.

Gjithashtu do të vazhdohet me promovimin dhe monitorimin e zbatimit të Udhëzuesit për politika ndëshkimore për të siguruar shkallë të lartë të uniformitetit në shqiptim të dënimeve nga gjykata dhe do të merren për bazë edhe rekomandimet e dhëna nga ana e Komisionit për zbatimin e strategjisë për sundimin e ligjit dhe planit të veprimit për strategji. Do të vazhdohet me promovimin dhe rritjen e shfrytëzimit të ndërmjetësimit si mjet alternativ për zgjidhjen e lëndëve, zbatimin e Strategjisë për TIK dhe SMIL për gjyqësor si dhe qëndrueshmërinë e Sistemit e Evidencës penale.

## **II. Organizimi dhe Raportimi**

Gjatë vitit 2024, udhëheqësit e departamenteve do ti raportojnë Kryetares së gjykatës për punën e departamenteve që dretojnë së paku njëherë në tre (3) muaj. Pjesë e raporteve duhet të jenë obligimet dhe detyrat që dalin nga Plani Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi.

Bashkëpunimi në mes të Divizioneve dhe Departamenteve me Udhëheqësit e Institucioneve, komunikimi i rregullt si dhe raportimi në baza të rregullta, janë planifikimet dhe synimet për vitin 2024 me qëllim të realizimit të plotë të Planit për përmirësimin e qasjes në drejtësi.

Shpërndarja e barabartë dhe caktimi i bashkëpunëtorëve profesional për secilin gjyqtar, është një hap që synojmë të arrijmë gjatë këtij viti dhe me këtë të rrisim efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve. Caktimi i bashkëpunëtorëve do të bëhet sipas kërkesave dhe procesit të punës si dhe sipas rezultateve të arritura nga ana e bashkëpunëtorëve të cilët gjithashtu do të vazhdojnë me raportimin për çdo tremujor të punës së tyre.

Trajtimi i lëndëve më të vjetra se 24 muaj do të vazhdojë të jetë prioritet dhe do ti kushtohet vëmendje e veçantë. Edhe në raportin e punës për vitin 2023, kemi paraqitur moshën e lëndëve në pritje, andaj për vitin 2024 kjo fushë do të jetë në monitorim të veçantë, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira sa i përket lëndëve në pritje më të vjetra se 12 muaj. Edhe në raportet tre mujore do të raportojmë në baza të rregullta për moshën e lëndëve në pritje.

Në planin e punës për vitin 2024, vazhdojnë punën dy (2) gjyqtare me angazhimet specifike dhe të veçanta dhe atë: një (1) gjyqtare koordinatore për monitorimin e rasteve të dhunës në familje në referatin penal dhe një (1) gjyqtare për trajtimin e rasteve të urdhër mbrojtjes në referatin civil, me qëllim të trajtimit në afat sa më të shpejta të këtyre rasteve, që edhe gjatë vitit 2023 ka rezultuar me sukses.

Në vitin 2024 do të pensionohen tre gjyqtarë dhe do të fillojnë punën tre gjyqtarë të ri. Dy gjyqtarë do të përfundojnë trajnimin bazik në muajin prill dhe do të fillojnë të ngarkohen me lëndë në muajin shkurt kur edhe janë caktuar në divizione në të cilat do të punojnë, një gjyqtar gjatë këtij viti do të fillojë trajnimet dhe në fund të këtij viti do të përfundojë trajnimin bazik dhe do të ngarkohet me lëndë. Gjyqtarët të cilët do të pensionohen, dy janë duke punuar në Departamentin

e Përgjithshëm - Divizioni Penal dhe një prej tyre në Divizionin e Kundërvajtjes, andaj bazuar në këtë gjatë këtij viti fokus i veçantë do të jetë forcimi dhe angazhimi i gjyqtareve të ri në Divizion Penal në mënyrë që të plotësohen vendet e gjyqtarëve të pensionuar dhe të evitohen ngecje në punën e Divizionit Penal të Departamentit të Përgjithshëm. Gjithashtu, edhe sa i përket stafit mbështetës do të pensionohen katër zyrtarë gjatë këtij viti dhe në vend të tyre duhet të plotësohen këto vende.

Gjykata Themelore në Prizren, tashmë në raportimet e rregullta shfrytëzon programin SMIL në punë të evidentimit dhe kryerjen e të gjitha punëve tjera si dhe për të siguruar të dhëna dhe statistika për gjendjen në gjykatë ku edhe në fund të vitit 2023 është bërë barazimi i lëndëve në SMIL me lëndët të cilat i kanë gjyqtarët në për zyre në mënyrë fizike, andaj gjatë vitit 2024 synojmë që programi të jetë 100% funksional dhe në shfrytëzim, në këtë drejtim gjyqtarët dhe stafi administrativ janë udhëzuar të kenë kujdes të veçantë në përmbushjen e hapave në këtë program.

Zbatimi i Strategjisë për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, si dhe planit të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, do të jenë synimet dhe parimet kryesore të punës për trajtimin e lëndëve gjatë vitit 2024 në të gjitha departamentet dhe divizionet.

### **III. Monitorimi**

Të gjitha këto synimet dhe qëllimet për vitin 2024, do të monitorohen në mënyrë të rregullt, në baza tre (3) mujore, ashtu që secili departament, divizion dhe sektor i gjykatës do të ketë përgjegjësinë që do të raporton tek Kryetarja e gjykatës, e këto raport do të përcillen edhe tek KGJK-ja dhe komisionet adekuate.

Tashmë është evidentuar dhe identifikuar grupi i lëndëve për tu trajtuar brenda vitit 2024, sipas udhëzimeve të Planeve Strategjike të KGJK-së dhe gjatë vitit 2024 synojmë të kemi raporte të sakta dhe të detajuara për gjendjen dhe ngarkesën me lëndë, duke iu referuar Planit për efikasitet dhe prioritetit.

Gjatë vitit 2024 kemi qëllim të monitorojmë trajtimin e lëndëve më të vjetra se 24 muaj, për secilin departament, numrin e lëndëve të kthyer në rigjykim, numrin e lëndëve që në gjashtë (6) muajt e ardhshëm arrijnë parashkrimin dhe atë për secilin gjyqtar.

Gjithashtu, nga gjyqtarët do të kërkojmë raporte për shtyrjen e seancave gjyqësore, arsyen e shtyrjes apo anulimit të seancave gjyqësore, në mënyrë që të evitojmë seancat jo produktive.

Gjyqtarët dhe udhëheqësit e departamenteve do të krijojnë raporte të veçanta tre mujore, për të paraqitur gjendjen e lëndëve që kanë në zyre dhe departament, duke specifikuar lëndët që rrezikojnë të parashkruhen, lëndët e shënjestruara, lëndët e natyrës së korrupsionit zyrtar si dhe lëndët tjera të përcaktuara në strategji si prioritet, Gjithashtu, divizioni civil do të ketë në fokus të veçantë lëndët që janë në rigjykim, kontestet të natyrave sociale, kontestet e punës, si dhe lëndët tjera të përcaktuara në strategji si prioritet.

Një kujdes dhe trajtim i veçantë gjatë vitit 2024, do të jetë edhe për zyrën për ekzekutimin e sanksioneve penale. Në muajin Janar - Shkurt do të bëhet evidentimi i saktë dhe mbyllja e lëndëve që nuk janë evidentuar si të tilla dhe pasi të evidentohen dhe identifikohen pengesat për ekzekutimin e lëndëve do të përpilohet një raport dhe plan i veprimit për vitin 2024.

#### ***IV. Përfundimi***

Bazuar në të lartcekura si Kryetare e gjykatës, dhe si autoritet kompetent, do të ndërmarr të gjitha veprimet konkrete në rastet kur gjyqtarët nuk zbatojnë masat e propozuara nga KGJK-ja.

Me qëllim të rritjes së efikasitet, synojmë që gjatë vitit 2024, të rritet zgjidhja e lëndëve përmes formave alternative, sikur në Gjykatën Themelore Prizren, ashtu edhe në degët Suharekë & Dragash. Për këtë në gjykatë do të krijojmë hapësirë të veçantë për zyrtarët për trajtimin e rasteve të ndërmjetësimit, kurse sa i përket degës në Gjykatën e Suharekës kemi filluar iniciativë që edhe në këtë gjykatë të funksionalizohet zyra për ndërmjetësim ashtu si e kemi edhe në gjykatën tonë. Kjo do të fillojë me punë në momentin kur të sigurojmë një zyrtar nga gjykata –bashkëpunëtor profesional i cili do të punojë në realizimit të procedurës së ndërmjetësimit.

Gjatë vitit 2024, Gjykata Themelore në Prizren dhe degët Suharekë & Dragash, synojmë që të tejkalojmë sfidat kryesor që kanë qenë vonesat në trajtimin e lëndëve në sistemin gjyqësor, rritja e profesionalizmit dhe kompetencës dhe rritja e llogaridhënies me qëllim të besueshmërisë së publikut.

Qasja në gjykatë për palët dhe qytetarët tashmë gjatë vitit 2024 do të jetë shumë më lehtë. Në tre mujorin e I-rë të vitit 2024 në bashkëpunimin me partnerët tanë do të bëjmë shenjëzimin dhe udhëzimet për të dy objektet e Gjykatës Themelore në Prizren, (objektin aktual dhe objektin e ri të Divizionit Civil) dhe kjo do të ndihmoj qasjen më të lehtë të qytetarëve dhe palëve që marrin shërbime në gjykatë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 planifikohet që një zyre në objektin e vjetër të gjykatës të adaptohet për pranimin e viktimave, personave të ndjeshëm dhe për fëmijë duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të rasteve ku viktima janë personat e lartcekur. Kjo do të realizohet pasi që të kërkohet mbështetja e KGJK-së dhe OSBE-së dhe pasi që të përpilohet plani i veprimit .

Për realizimin e synimeve dhe qëllimeve të lartcekura sa i përket trajtimin të lëndëve dhe efikasiteti profesional, gjykata ka nevojë për mbështetje nga Sekretariati i KGJK-së, dhe përmbushjen e kërkesë për plotësimin e vendeve të punës të stafit administrativ, siç janë: recepsionist, vozitës, arkivist, përkthyes etj, si për Gjykatën Themelore në Prizren ashtu edhe për degën e Gjykatës Themelore – Suharekë, sipas kërkesave të Administratorit dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

Gjatë vitit 2023, unë si Kryetare e gjykatës së bashku me stafin mbështetës kemi treguar vullnetin dhe angazhimin për ndryshim, ashtu që tashmë kemi ofruar kushte dhe ambient më të mirë të punës për gjyqtarët dhe stafin dhe qytetarët kanë qasje më të lehtë dhe hapësira adekuate në objektet e gjykatës, ku edhe kemi arritur sukses në realizimin e planit të punës në 106%, andaj gjatë vitit 2024 presim edhe mbështetjen e KGJK-së, për realizimin e synimeve dhe detyrave të punës me qëllim të rritjes së besueshmërisë së qytetarëve në Institucionet e drejtësisë.

*Kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren*



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENÛ - BASIC COURT OF PRIZREN